

NJOFTIM PËR MEDIA

Sot, më datë 09.09.2024, ora 15:30, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Nafije Hasko (Relatore);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 5. Sokol Ibi (Anëtar);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, shqyrtoi çështjet Nr.5 dhe Nr.6 Regj.Themeltar Dt.30.08.2024 Regjistrimi¹, me:

PADITËSA: - Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Av.Franci Nuri.
- Partia “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”, përfaqësuar nga Z.Vangjel Dule.

IPADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - KQZ, përfaqësuar nga Z.Erdal Mema, Z.Erion Meta dhe Z.Gerion Vezuli.

PERSON I INTERESUAR: Subjekti Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në mungesë.

OBJEKTI: - Ndryshimin e Vendimit nr.19, datë 26.08.2024 të Komisionit për Ankimimet dhe Sanksionet (KAS) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Konstatimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha Qendrat e Votimit (gjithsej 36 QV- të) të zonës zgjedhore Bashkia Himarë.
- Rregullimin e pasojave duke shpallur përsëritjen e zgjedhjeve në zonën zgjedhore Bashkia Himarë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 45 dhe 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenet 2/27, 145, 152, 153, 155, 160, 179 dhe vijues të Kodit Zgjedhor, Nenet 5, 5/1 e vijues të Ligjit Nr.8952 Dt.10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve”.

Për dijeni, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), me Vendimin Nr.19 Dt.26.08.2024, objekt i kërkesëpadive, ka vendosur:

“1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.11, datë 09.08.2024, të depozituar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 85, datë 05.08.2024 të KZAZ nr. 88, Qarku Vlorë “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himare”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij

¹ Bazuar në vendimin e ndërmjetëm të bashkimit të dy çështjeve.

vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor”.

Ndërsa, Kërkesa Ankimore Nr.11 Dt. 09.08.2024, e paraqitur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), kishte për objekt:

“1. Kundërshtim i Vendimit nr.85, datë 05.08.2024 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për Zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himarë në zgjedhjet e pjesshme të datës 04.08.2024”, të KZAZ nr. 88.

2. Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha QV (gjithsej 36 QV- të) të zonës zgjedhore Bashkia Himarë.

3. Rregullimin e pasojave duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve për bashkinë Himarë.”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me Vendimin Nr.5 Dt.09.09.2024, unanimitisht:

VENDOSI

1. Rrëzimin e padisë së palës paditëse Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe Partia “Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, më datë 09.09.2024.

Tiranë, më 09.09.2024

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë